



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:190762
Datë: 12.04.2024
Numri i dokumentit: 05569764

Ac.nr.7704/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Nora Bllaca-Dula, kryetare e kolegjit, Faton Ademi dhe Burim Shala, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike-kontestimore të paditësve K.K, L.T, E.U, F.H dhe N.A, të cilët i përfaqëson sipas autorizimit B.P, avokat nga Komuna e V....., kundër të paditurës Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Punëve të Brendshme, Polica e Kosovës, Drejtoria e Përgjithshme, në Prishtinë, Rruga “Luan Haradinaj” p.n., të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore në Ministrinë e Drejtësisë të Republikës së Kosovës, me objekt kontesti kompensim i pagës së trembëdhjetë, shpërblimit jubilar dhe shujtave ditore, duke vendosur në lidhje me ankesën e palës së paditur të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.6845/2021, i datës 28.09.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 04.04.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET e pathemeltë ankesa e të paditurës Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Punëve të Brendshme, Polica e Kosovës, Drejtoria e Përgjithshme në Prishtinë, Rruga “Luan Haradinaj” p.n, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.6845/2021, i datës 28.09.2023, në pikën I të dispozitivit të aktgjykimi të ankimuar, VËRTETOHET.

II. Mbetet e pashqyrtuar pika II e dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar, në pjesën refuzuese të kërkesëpadisë.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.nr.6845/2021, i datës 28.09.2023 ka vendosur si në vijim:

“I. APROVOHET E BAZUAR pjesërisht kërkesëpadia e paditësve K.K, L.T, E.U, F.H dhe N.A, dhe DETYROHET e paditura Ministria e Punëve të Brendshme, Polica e Kosovës, Drejtoria e Përgjithshme në Prishtinë, paditësve t’ia paguaj shumat si vijon:

- Paditësit të parë K.K, në emër të shpërblimit të pagës së trembëdhjetë për fund vitet 2018 dhe 2020, për çdo vit t’ia paguaj në vlerë të pagës bazë nga 531.90 €, shumën në lartësi prej 1,063.80€;

- Paditësit të dytë L.T, në emër të shpërblimit të pagës së trembëdhjetë për fund vitet 2018 dhe 2020, për çdo vit t’ia paguaj në vlerë të pagës bazë nga 531.90 €, shumën në lartësi prej 1,063.80€;

- Paditësit të tretë E.U, në emër të shpërblimit të pagës së trembëdhjetë për fund vitet 2018, 2019 dhe 2020, për çdo vit t’ia paguaj në vlerë të pagës bazë nga 571.90 €, shumën në lartësi prej 1,715.70€; si dhe në emër të shpërblimit jubilar për 10 vite përvojë pune në vlerë të 25% të një page mesatare të vitit 2021 në vlerë prej 160.62 euro në shumë të përgjithshme prej 1,876.32 euro;

- Paditësit të katërt F.H, në emër të shpërblimit të pagës së trembëdhjetë për fund vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021, për çdo vit t’ia paguaj në vlerë të pagës bazë nga 496.90€, shumën në lartësi prej 1,490.70€;

- Paditësit të pestë N.A, në emër të shpërblimit të pagës së trembëdhjetë për fund vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021, për çdo vit t’ia paguaj në vlerë të pagës bazë nga 570.24 €, shumën në lartësi prej 1,710.72 €; si dhe si dhe në emër të shpërblimit jubilar për 10 vite përvojë pune në vlerë të 25% të një page mesatare të vitit 2022 në vlerë prej 142.97 euro në shumë të përgjithshme prej 7,853.69 euro-

- me kamatë ligjore në lartësi prej 8 % në vit nga dita e parashtrimit të padisë 29.09.20021 e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet procedurës kontestimore, në shumën prej 724.00 €, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë ë këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit.

III. REFUZOHET në tërësi kërkesat e paditësve, me të cilat kanë kërkuar që të detyrohet e paditura, që paditësit të dytë, të tretë, të katërt, dhe të pestë, t’iu paguaj në emër të shpërblimit jubilar për 10 vite përvojë pune, 25% e pagës bazë, si dhe refuzohet kërkesa në emër të shujtave ditore nga 3 euro (tri), për çdo ditë të prezencës së paditësve në punë, për periudhën kohore 14.11.2018 e deri më datë 23.02.2022 apo për 740 ditë, të punës për secilin paditës, dhe atë për secilin veç e veç, nga 2,220.00 euro, si e pabazuar. Po ashtu refuzohet shuma prej 620.10 euro për paditësin A.M si e pa bazuar”.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka paraqitur pala e paditur, përmes të autorizuarit të saj, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit, ankesën t’ia aprovohet si të bazuar, ta prish aktgjykimin e shkallës së parë ose të refuzohet si e pabazuar në tërësi kërkesëpadia e paditësve.

Përgjigje në ankesë kanë paraqitur paditësit përmes të autorizuarit të tyre duke e kundërshtuar në tërësi ankesën e të paditurës me propozim që e njëjta të refuzohet si e pabazuar ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa e të paditurës është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësit, përmes të autorizuarit të tyre, më datë 29.09.2021, kanë paraqitur padi në gjykatën e shkallës së parë, kundër të paditurës, ndërsa me datën 21.03.2022 kanë precizuar kërkesëpadinë në kuptimin objektiv duke kërkuar:

Paditësi i parë-K.K ka kërkuar që në emër të pagës së 13, të shpërblehet me një pagë të rregullt mujore, për vitet 2018, 2019, 2020, dhe 2021, nga 531.90 euro për secilin vit, sa është paga mujore momentale, apo për katër vitet shumën prej 2,127.60 euro. Në emër të ushqimit – shujtave ditore ka kërkuar kompensim nga 3 euro në ditë, për periudhën kohore 14.11.2018 – 23.02.2022, apo për 740 ditë të prezencës në punë, shumën prej 2,220.00 euro.

Paditësi i dytë-L.T ka kërkuar që në emër të pagës së 13, të shpërblehet me një pagë të rregullt mujore, për vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021, nga 531.90 euro për secilin vit, sa është paga mujore momentale, apo për katër vitet shumën prej 2,127.60 euro. Në emër të ushqimit – shujtave ditore ka kërkuar kompensim nga 3 euro në ditë, për periudhën e kohore 14.11.2018 – 23.02.2022, apo për 740 ditë të prezencës në punë, shumën prej 2,220.00 euro.

Paditësi i tretë-E.U ka kërkuar që në emër të pagës së 13, të shpërblehet me një pagë të rregullt mujore, për vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021, nga 571.90 euro për secilin vit, sa është paga mujore momentale, apo për katër vitet shumën prej 2,287.60 euro. Në emër të kompensimit të pagës jubilarë për përvojë të punës 19 vjeçare, të paguaj 25%, të një page bazë apo shumën prej 142.00 euro. Në emër të ushqimit – shujtave ditore ka kërkuar kompensim nga 3 euro në ditë, për periudhën e kohore 14.11.2018 – 23.02.2022, apo për 740 ditë të prezencës në punë, shumën prej 2,220.00 euro.

Paditësi i katërt-F.H ka kërkuar që në emër të pagës së 13, të shpërblehet me një pagë të rregullt mujore, për vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021, nga 496.90 euro për secilin vit, sa është paga mujore momentale, apo për katër vitet shumën prej 1,987.60 euro. Në emër të ushqimit – shujtave ditore ka kërkuar kompensim nga 3 euro në ditë, për periudhën e kohore 14.11.2018 – 23.02.2022, apo për 740 ditë të prezencës në punë, shumën prej 2,220.00 euro.

Paditësi i pestë-N.A ka kërkuar që në emër të pagës së 13, të shpërblehet me një pagë të rregullt mujore, për vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021, nga 570.24 euro për secilin vit, sa është paga mujore momentale, apo për katër vitet shumën prej 2,280.96 euro. Në emër të kompensimit të pagës jubilarë për përvojë të punës 19 vjeçare, të paguaj 25%, të një page bazë apo shumën prej 142.00 euro. Në emër të ushqimit – shujtave ditore ka kërkuar kompensim nga 3 euro në ditë, për periudhën e kohore 14.11.2018 – 23.02.2022, apo për 740 ditë të prezencës në punë, shumën prej 2,220.00 euro. Të gjitha kërkesat e lartcekura për secilin paditës me kamatë ligjore prej 8% në vit, nga momenti i parashtrimit të padisë e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësve dhe precizimit të kërkesëpadisë, pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi, në kuptim të nenit 398 dhe nenin 399 të LPK-së, jashtë seance ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar

C.nr.6845/2021, i datës 28.09.2023, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht të themeltë kërkesëpadinë e paditësve, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të ankimuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se paditësit janë të punësuar tek e paditura, pasi kjo është vërtetuar në bazë të vërtetimit të punësimit, ndërsa pagën për periudhën kohore për të cilën e kanë parashtruar padinë e kanë bazuar në vërtetimin e punësimit të lëshuar nga e paditura. Po ashtu gjykata ka vërtetuar faktin e punësimit të paditësve tek e paditura, pagën e muajit dhjetor për vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021 në bazë të listës së pagave, vlerësimin e performancës së paditësit për vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021 janë vlerësuar me vlerësim të kënaqshëm, ku paditësi i parë-K.K e ka filluar punën te e paditura nga data 21.09.2015, dhe realizon pagë mujore në shumë prej 531.90€. Paditësi i dytë-L.T, e ka filluar punën te e paditura nga data 21.09.2015, dhe realizon pagë mujore në shumë prej 531.90€. Paditësi i tretë-E.U e ka filluar punën te e paditura nga data 24.09.2001, dhe realizon pagë mujore në shumë prej 571.90€. Paditësi i katërt-F.H e ka filluar punën te e paditura nga data 21.09.2015, dhe realizon pagë mujore në shumë prej 496.90€, dhe paditësi i pestë-N.A e ka filluar punën te e paditura nga data 15.04.2002, dhe realizon pagë mujore, në shumë prej 570.24€.

Tutje gjykata e shkallës së parë ka shtuar se, e paditura ka pasur detyrim që paditësve si të punësuar të saj t'iu paguaj pagën e 13-të për çdo fund vit, pasi janë plotësuar kushtet nga ana e paditësve siç parashihen me nenin 29 paragrafi 1 të Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 të datës 14.11.2018 si dhe nenit 30 paragrafi 1 të Udhëzimit Administrativ Nr.02/2021, me saktësisht, vlerësimi i performancës për vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021, e po ashtu ndaj të njëjtëve nuk është shqiptuar asnjë masë disiplinore.

Sa i përket pjesës refuzuese gjykata ka vendosur si në piken II të dispozitivit të aktgjykimit të ankimor, duke konstatuar se paditësve nuk iu takon kompensimi i ushqimit në punë (shujtave), bazuar në nenin 29 paragrafi 1 të UA 02/18 dhe nenit 47 paragrafi 4 të Ligjit nr. 04/L-076, për arsye se përcaktimi në aktet ligjore dhe nënligjore për shujta ditore duhet të jetë shprehimisht i përcaktuar që të mund të vie në shprehje zbatimi i kësaj dispozite, ndërsa në rastin konkret meqë nuk ekziston ky përcaktim në legjislacionin në fuqi, e as në aktet nënligjore, kjo dispozitë mbetet e karakterit deklarativ. Poashtu, ka vlerësuar dhe konstatuar se nuk iu takon kompensimi në emër të pagave të trembëdhjeta paditësve K.K dhe L.T, pasi këta të fundit nuk kanë prova lidhur me lartësinë e pagës dhe formularët e vlerësimit të performancës për vitet e kërkuara si në kërkesë padi, ku e njëjta vlen edhe për vitet e refuzuara të paditësve të tjerë. Në pikën e njëjtë refuzuese për kompensimin e shpërblimit jubilar paditësve K.K, L.T, dhe F.H, gjykata u bazuar se UA nr. 02/2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, i datës 14.11.2018, ka hyrë në fuqi në vitin 2018, ndërsa në rastin konkret vitet jubilarë të lartcekurit i kanë mbushur para hyrjes në fuqi të këtij UA, në vitin 2015, dhe ky UA nuk prodhon efekte juridike prapavepruese.

Gjykata për kamatën ka vendosur duke u bazuar në dispozitën e nenit 382 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve dhe Mendimit Juridik për Kamatat i Gjykatës Supreme të Kosovës i datës 02.12.2020, ndërsa vendimin për shpenzimet e procedurës e ka marrë konform nenit, 449 dhe 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi juridik i Gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, gjendja faktike është vlerësuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n) e LPK-së (kuptohet nga referati i ankesës). Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Sa i përket pretendimit ankimor se kërkesëpadia e paditësve është parashkruar, kjo gjykatë vlerësoi se një pretendim të tillë e paditura nuk e ka parashtruar gjatë përgjigjes në padi të cilën gjykata e shkallës së parë e kishte ftuar që të paraqesë andaj meqenëse kjo nuk e ka paraqitur përgjigjen në padi tani një pretendim i tillë nuk mund të paraqitet në ankesë, ngase sipas nenit 180.3 të LPK-së, parashihet se *“Prapësimi i parashkrimit dhe prapësim me qëllim kompensimi, që nuk janë paraqitur në gjykimin e shkallës së parë, nuk mund të paraqiten me ankesë”*, andaj një pretendim i tillë është në kundërshtim me dispozitën e lartcekur.

Në raport me pretendimin për vërtetim të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike po ashtu kjo nuk qëndron sepse nga provat e administruara dhe vlerësuara nga ana e gjykatës së shkallës së parë janë vërtetuar këto fakte: punësimi i paditësve tek e paditura, vlerësimi pozitiv i paditësve nga e paditura për vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021 dhe mungesa e shqiptimit të ndonjë mase në procedurë disiplinore, lartësia e pagave është vërtetuar me dokument zyrtar siç është lista e pagave dhe është bazuar në pagën e muajit dhjetor për vitet kontestuese (ku në bazë të listës së pagave vërtetohet se shumica e përgjithshme për tri vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021 është shumica si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar), e paditura nuk ka arritur të provojë se i'a ka kompensuar paditësve pagat e kërkuara.

Nuk qëndron pretendimi ankimor në raport me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale pasi që me udhëzimin Administrativ Nr.02/2018 mbi marrëdhënien e punës ne Policinë e Kosovës dhe atë me nenin 29.1 tek e drejta në pagë dhe e shpërblimit, përcaktohet se *“Paga bazë, shtesat për rrezikshmërinë në punë, puna jashtë orarit, gjatë festave, shujtë ditore, veshmbathje (për zyrtarët policorë) dhe sigurim shëndetësor për personelin e Policisë duhet të jetë në përputhje me vendin e punës, gradën, kualifikimin dhe përvojën e punës, duke u mbështetur në Ligjin për Policinë, sistemin e pagave dhe shtesave në Polici”*, ndërsa me të njëjtin, nen paragrafi 2. përcaktohet se *“Personelit të Policisë të cilët kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës, do të përfitojnë si shpërblim një page mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore ne fund te vitit”*.

Paditësit i plotësojnë kushtet për të përfituar një kompensim të tillë, pasi që janë në marrëdhënie pune tek e paditura, nuk kanë pasur masë disiplinore të shqiptuar për vitet kontestuese, 2018, 2019, 2020 dhe 2021, ndërsa kanë pasur vlerësim të mirë për këto vite, lartësia e pagës është përcaktuar në bazë të listës së pagave për vitet, 2018, 2019, 2020 dhe 2021 si dokument publik lëshuar nga e paditura.

Pretendimi për mungesë buxheti apo mos harmonizimi i Udhëzimit Administrativ me Ligjin për buxhetin është aspekt i brendshëm i të paditurës me organet e veta, pastaj përderisa Udhëzimi Administrativ ka qenë në fuqi, e paditura nuk mund t'i shmanget detyrimit për përmbushje. Fakti se nuk është bërë përmbushja në procedurë të brendshme administrative nuk nënkupton mungesë të bazës juridike për t'u detyruar nga gjykata për përmbushje.

Lidhur me kamatën është vendosur konform nenit 382 paragrafi 1 dhe 2 të LMD-së, ku përcaktohet lartësia prej 8% në vit dhe Mendimit Juridik për Kamatat i Gjykatës Supreme të Kosovës i datës 02.12.2020, ndërsa e njëjta fillon të rrjedhë nga dita e paraqitjes së padisë pasi bëhet fjalë për dëm material.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese dhe në pajtim me dispozitat e 449 dhe 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nuk e ka shqyrtuar aktgjykimin e atakuar në pikën II të dispozitivit në pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë, ngase nuk kishte pretendime ankimore në këtë drejtim.

Gjykata i shqyrtoi edhe pretendimet e tjera ankimore por të njëjtat ishin pa ndikim për një vendimmarrje ndryshe nga ajo që u vendos në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195.1 pika d), lidhur me nenin 200, të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.7704/2023, me datë 04.04.2024

Kryetarja e kolegjit
Nora Bllaca-Dula, d.v